



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

FTOJ

Mbledhjen e gjashtë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **11.06.2019** (e martë) duke filluar në orën **11:00**.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Informim nga Zyrja Komunale për Komunitete rreth aktiviteteve mujore, diskutimi i qështjeve të ndryshme si dhe kërkesave të qytetarve;
3. Të ndryshme;

Me: 06.06.2019
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo – Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 15.05.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Abdyl Gashi, Behare Jashari, Jorgovanka Filic, ZKKK Sami Vllasaliu, Komandanti i Stacionit Policor Gani Huruglica, Drejtori i Qendres për Punë Sociale Nikolla Jankovic, Drejtori i Qendres për Punësim Mehmet Gashi, përfaqësuesit e UNMIK-ut, dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Novobërdës;
3. Diskutim rreth emrimit të rrugëve në fshatrat e Komunës;
4. Raport nga Drejtori i qendres për punë sociale mbi numrin e rasteve sociale nga secili komunitet;
5. Raport nga Drejtori i zyres për punësim lidhur me projektet për punësim për komunitetet;
6. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore të zyrës apo çështjeve/kërkesave të komuniteteve;
7. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kanë ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pat diskutime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: e kam një vërejtje për procesverbal pasi që është mbledhja e tretë që procesverbalin në gjuhën serbe nuk e kemi marrë.

Jorgovanka Filic tha: pajtohem me kolegun pasi që disa mbledhje nuk e kemi procesverbalin në gjuhën serbe.

Shpresa Kqiku tha: perkthyesi Fatmiri i cili është përgjegjës nuk e ka perkthyer edhe pse e kemi njoftuar që duhet të perkthej.

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: mendoj se përgjegjësin për perkthim duhet ta mbaj ai që e ka dhe është e padrejt që procesverbali nuk vjen në të dy gjuhët.

Kryesuesja tha: atëherë po e shtym për mbledhjen tjetër po shpresojmë se do të kemi të gjithë procesverbalet.

Pika e dytë: Gjendja e sigurisë në Komunën e Novobërdës;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Komandantit të Policisë Gani Huruglica.

Gani Huruglica pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket sitautes të sigurisë në Komunën e Novobërdës vlersohet e qetë dhe stabile nuk ka incidente që vlen të theksohen meqense ka disa raste kriminale të raportuara dhe ka ankesa të qytetarëve në disa fusha. Për vitin 2019 deri me tani janë raportuar gjithësej 60 raste duke i përfshi edhe incidentet e trafikut. Kemi pasur një protest në fshatin Kufc m qellim që institucionet përgjegjëse ti vendosin disa shenja komunikacioni, kerkesen e kan derguar te ne në polici dhe ne e kemi derguar në Drejtori të Sherbimeve Publike që ta shqyrtojn, gjithashtu kemi pasur disa ankesa nga qytetarët për fshatin Llabjan per disa banorë të cilët ndezin qymyr dhe ndotin ambientin ne si Polici kemi biseduar drejtpërdrejt me D.SH.P. në kohet e fundit nuk kemi pasur të lajmëruar raste të vjedhjeve pasi që kemi marrë disa masa të duhura, kemi rritur patrollimet sidomos gjatë nates edhe pse është pak e veshtir me numër të vogel të policeve të mbulohet gjithë teritori, nuk kam diçka tjetër nese keni pyetje urnoni, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: e kam një pyetje se deri ku ka arritur kategorizimi i Stacionit Policor nga C në B, si dhe a është i njoftuar komandanti i policis për formimin e KKSB-së.

Gani Huruglica tha: satacioni në Novobërdë i perket kategoris C por nevojat dhe kerkesaj janë që të kalojn në kategorin B për ata që se din kjo kategori është numer më i madhë i stafit si dhe i mjeteve logjistike dhe i objektit, ne kerkesen e kemi bërë por nuk është aprovuar ende. Sa i perket KKSB-së është bërë kërkesa prej fshatit Kufc dhe Stanishor në atë kerkes janë shtatë antarë dhe ne e kemi drejtu në Drejtori të pergjishëm, të gjithë duhet të din se antarët që propozohen në këto kshilla duhet të kenë të kaluar të paster kriminale.

Abdyl Gashi tha: është diskutuar pasi që ka ardhur një kërkes prej Policisë që permes Kuvendit të ndahet një parcel për ndertimin e një Stacioni për ska qenë e specifikuar sakt parcela dhe vendi. Pasi që teritori është i shperndam sa është e mundur që të jetë edhe një nënstacion në fshatin Llabjan dhe qështja tjetër është për vjedhjen e bagëtive që pothuajse ka kaluar në normalitet, sa persona kan dala para drejtësisë për këto raste dhe çfarë masa keni marrë?

Gani Huruglica tha: së pari objekti i stacionit të policis nuk i plotëson as kushtet normale për punë, ne e kemi bërë një kërkes që të na ndahet një parcel që do të ishte e pershtatshme, në fillim e kemi menduar token të shkolla e mesme ekonomike por aty është ozurpuar nga qendra strehimore, kerkesen Drjtoresh e ka bërë në Komunë, Komuna e ka dergu në Kuvend dhe Kuvendi nuk e ka aprovuar pasi që disa antar kanë kërkuar që ky stacion të ndertohen në Stanishor apo Kufcë si dhe nuk ka pasur lokacion pronë publike për shfrytëzim, ne e kemi breng shumë të madhe pasi që infrastruktuar e objektit duhet të jet shumë më adekuate. Sa i perket rreth vjedhjes të baktisë po vazhdojm që ta parandalojm dhe jemi në kontakt të vazhdueshem edhe me njesit speciale dhe hetimet rajonale që sipas tyre janë afer ndriqimit të këtyre rsateve, ne jemi duke e dhënë maximumin por deri më tani ende nuk ka dalur askush para drejtësisë shpresoj se së shpejti do ti zbulojm kryesit e këtyre veprave. Sa i perket stacionit në Llabjan nuk është lokacioni i pershtatshem pasi që janë larg vendbanimet tjera.

Abdyl Gashi tha: nuk mendova që të jetë stacioni kryesor në Llabjan por një nënstacion pasi që Llabjani është një vendbanim shumë i madhë.

Gani Huruglica tha: me kategorin C qe jemi ne e kemi problem që të kemi nënstacione dhe pika referuese.

Sami Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: shqetësimi im si banor i fshatit Vllasali dhe i banorëve tjerë është se shpesh po kemi problem me banorët e Komunave tjera që po marrin ujë në fshatin Vllasali, deri më tani ka pasur shumë incidente por nuk janë raportuar, në javen e fundit ka

genë një incident nga një banor i fshatit dhe një banor tjetër ku ka ndodhur rrahja mes këtyre personave.

Gani Huruglica tha: është lajmëruar ky rast e di se është sulmuar një qytetarë i Gjilanit me thik i cili është vlersuar si lëndim i lehtë trupor, andaj ju ftoj të gjithëve që të bashkpunoni me policinë për çdo rast.

Abdyl Gashi tha: një shqetësim tjetër është rruga të tregu në Llabjan e cila pothuajse totalisht bllokohet për 5-6 orë dhe aty nuk kemi parë asnjë masë të marrë nga policia rajonale.

Gani Huruglica tha: plotësisht me të drejtë po thu këto shqetësime këtu së pari duhet të bashkëpunojmë edhe me inspektorët Komunal. Sa i përket lokacionit të Tregut aty nuk po u plotësojnë asnjë kusht për me u mbajtur ai treg dhe Komuna duhet të marrë veprime konkrete. Patrolla policore gjatë ditës së diel është e caktuar aty por në mungesë të kapacitetve që i kemi në rast të ndonjë thirrje tjetër policia i përgjigjet thirrjes, unë kam kaluar vetë personalisht dhe e kam parë që rruga është e bllokuar dhe trotualet të nxonta, disa qytetar vendosin blloka në trotuar si të ishte pronë private e tyre.

Dobrivoje Djordjevic tha: e kam edhe unë një pyetje për kamionet të cilët kalojnë në Stanishor dhe askush nuk i kontrollon, e transportojnë zallin pa e mbulur dhe krijojnë shumë pluhur.

Gani Huruglica tha: ankesat e banorëve të fshatit Stanishor janë shumë shqetësuese, ndotja e ambientit prej transportuesve, fatkeqësisht nuk është bërë ende asnjë zgjidhje, jam informuar se është propozuar që të kalojë në rrugë tjetër në fshat por ende nuk është aprovuar, nuk është vetëm punë e jona por këtë zgjidhje duhet ta bëjë Komuna.

Mehmet Gashi pasi përshëndeti të pranishmit tha: bllokat i kam vendosur unë, pasi që disa qytetarë i kanë lënë veturat në trotuar dhe mi kanë vjedhur bletet e askush nuk më ka dhënë përgjigje, trotuari është për këmbësor nuk është për vetura.

Gani Huruglica tha: kuptohet se ju ndalohet automjeteve të parkohen në trotuar pasi që vlen për këmbësor, me ligj denohen ata që parkojnë ilegal.

Abdyl Gashi tha: mendoj se edhe policia e ka një obligim ligjor që të dërgoj një shkresë Kryetarit të Komunës që tju bëjë zgjidhje personave që shesin në treg dhe ata që kanë nevojë për parking.

Pika e tretë: Diskutim rreth emërimit të rrugëve në fshatrat e Komunës;

Kryesuesja tha: perseri askush nuk ka ardhur për këtë pikë edhe pse është dërguar ftesa si kopje fizike ashtu edhe elektronike.

Abdyl Gashi tha: është e pandërgjegjshme pasi që është e vetmja Komunë që nuk e ka bërë emërimin e rrugëve ende, ne më heret biseduam për sigurim por policia ende nuk i njohin rrugët zyrtare të Komunës tonë, mendoj se kjo pikë duhet të bartet edhe në senacen e Kuvendit Komunal.

Pika e katërt: Raport nga Drejtori i qendrës për punë sociale mbi numrin e rasteve sociale nga secili komunitet;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale Nikolla Jankovic.

Nikolla Jankovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: në Komunën tonë jetojnë tri komunitete, komuniteti Serb, Shqiptarë dhe Rom. Sa i përket numrit të rasteve sociale gjithësej janë 470 familje me ndihmë sociale, prej tyre 12 raste nga komuniteti Rom, 296 nga komuniteti Serb dhe 162 nga komuniteti Shqiptar, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: cilat janë kriteret për përfituesit e ndihmës sociale?

Nikolla Jankovic tha: varet prej rasteve pasi që ka familje që kanë fëmijë të palevizshëm dhe e marrin deri në moshën 18 vjeç, ndërsa familjet e tjera e marrin socialin për fëmijet deri në 5 vjeç.

Abdyl Gashi tha: e kam një shqetësim rreth vlerësimit të disa banorëve të cilët marrin pa merit ndihmën sociale ndërsa ata të cilët e meritojnë nuk e marrin, i njoh familjet që i kanë shtepin 3 kat dhe kanë të hyra mbi 600 euro, nuk e di a është arsye politike por kjo është e dhimbshme, andaj duhet të bëhet një vlerësim më i drejtë.

Nikolla Jankovic tha: nuk ka raste të tilla nuk ka mundësi që dikush ka të ardhura tjera të merr ndihmë sociale, nese ka kisha pasur deshir ta njoh.

Abdyl Gashi tha: njoh shumë familje por nuk është në kompetencen time që ta flas.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: në Komunën e Novobërdës ndihma sociale ndahet simbas Drejtorit, simbas njoftësisë, si është e mundur 470 persona të marrin ndihmë sociale në Komunën e Novobërdës me 7000 banorë kurse Komuna e Gjilanit i ka 1300 raste sociale me 80,000 banor. Si është e mundur në Komunën e Gjilani nese ka kerr nuk merr social a në Komunën tonë ka të ardhurat a në Komunën tonë kan 300,000€ në vit dhe marrin social. Por Qeveria i ka caktuar gabim kriteret si caktohet deri në moshen 5 vjet të mirret sociali, sociali ska moshë por mirret deri në vdekje nese është invalid i paaftë për punë dhe ska kushte.

Pika e pestë: Raport nga Drejtori i zyres për punësim lidhur me projektet për punësim për komunitetet;

Kryesuesja e Komitetit për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Qendres për Punësim Mehmet Gashi.

Mehmet Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: ne si zyre për punësim në kuader të Ministrisë për punë dhe Mireqenje Sociale i kemi 1,857 punë kerkues të regjistruar, kemi bërë kshillime në punësim 10,505, punëdhëns të regjistruar i kemi 94, vizita të realizuara 442, vende të lira të regjistruara 156, ndermjetësime në punësim të rregullt 70, ndermjetësime në trajnime të rregullta 7, ndermjetësime në punë publike 270, ndermjetësime në trajnime përpunë 24, ndermjetësime në subvencione 22, këto janë për vitin e kaluar. Sa i përket këtij viti punë kerkues të rinjë të regjistruar i kemi 42, kshillime 334, punëdhënës të regjistruar 5, vizita të realizuara 44, vende të lira të rregullt 1, ndermjetësime në punësim të rregullt 1, ndermjetësime në punë publike 13, ndermjetësime në subvencione 8, trajnim të rregullt 1. Sa i perket punës të gjithë janë të perfshir barabart pa marrë parasysh komunitetin.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobriroje Djordjevic tha: është një raport i mirë është një shembull i mirë që duhet të marrin të tjeret se si të punohet dhe të punojnë edhe të tjeret si ky instiucion.

Abdyl Gashi tha: vendet e lira të punës a zavendesohen me kalimin e kohës?

Mehmet Gashi tha: te ne vendet e lira të punës më shumë se 10 ditë nuk kemi të drejt ti lëjm të lira, këto bëjnë pjesë projektet prej organizatave të ndryshme dhe proceduar e realizimit është 10 ditore.

Pika e gjashtë: Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën ZKKK Sami Vllasaliu.

Sami Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimish kerkoj falje në emer të Shefes së Zyrres pasi që ka pasur një takim. ZKKK gjatë këtij muaji ka punuar në këto punë dhe aktivitete: është mbajtur takim i bordit qendror të projektit RRK V dhe janë aprovuar 8 shtepi për ndertim, kemi mbajtur takim më OSBE-n në lidhje me eksproporimin e tokave, kemi mbajtur takim me komisionin e gjuhëve në lidhje me ndryshimin e ligjit për gjuhët dhe është dorzuar raporti i perdorimit të gjuhëve, kemi bërë monitorimin e të kthyerve të projektit të kaluar të RRK V, vazhdimi i implemnetimit në projektin DRC, kemi bërë pranimin tekink të objekteve të perfunduara, kemi mbajtur trajnim më KFOR ku kan marrë pjesë grat më shumë me temen vetmbrojtja, puna me persona të kthyer, puna me persona të riatdhesuar.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobriroje Djordjevic tha: këto na ka thënë Jasmina edhe në muajt e kaluar a ka diçka tjeter që keni punuar?.

Sami Vllasaliu tha: po Zyrja jonë nuk punë më asfaltim të rrugëve, ne punojm me projekte për të kthyerit që fillojn dhe vazhdohen të realizohen.

Zymer Zymeri tha: po e pyes se kush do të perfitoj në këto 8 shtepi që do të ndertohen dhe cilat kushte duhet të plotësohen?.

Sami Vllasaliu tha: perfituesit janë të komunitetit serb pasi që kriteret janë patjeter që duhet me qenë I kthyer dhe të kthyer kemi vetem nga komuniteti serb.

Abdyl Gashi tha: sa % e projekteve kanë perfituar komunitete si Shqiptarë, Serb dhe Rom po ashtu kam kerkuar që të di se sa familjar janë të regjistruar dhe sa janë të shperngulur?.

Sami Vllasaliu tha: sa I perket këtyre shenimeve nuk mund ti kemi ta sakta pasi që të zhvendosur mund të ketë çdo ditë, sa I perket sa janë të regjistruar janë perafersht 85 raste persona të riatdhesuar.

Pika e shtatë: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: e kam ngrit edhe më heret qështjen e ujësjellësit në Llabjan dhe kerkoj që kjo pikë të shkoj në Kuvend, se pse ky ujësjellës nuk ka hy në menaxhim të Hidromoraves dhe qështja tjetër është për ndriqim publik në gjithë Komunën edhe pse ka kushtuar me mijra euro është jashtë funksionit.


Kryesuesja i pyeti se kush janë për aprovimin e këtyre propozimeve që të shkojnë në Kuvend.

Aprovohen njëzëri këto propozime nga antarët prezen të Komitetit që të shkojnë në Kuvend.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:25

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

